



REAGIM PUBLIK I OBSERVATORIT NË NIVEL KOMBËTAR

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve nëpërmjet përfaqësuesve në 12 qarqet e vendit me fokus monitorimin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve **reagon publikisht në lidhje me dhunën e shkaktuar ndaj fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës në Shkodër (Parashkollor 3-6 vjeç).**

E dhimbshme, e pafalshme dhe skandaloze është sjellja e dhunshme dhe poshtëruese e një ekipi të papërgjegjshëm kujdestarësh, ndaj fëmijëve të pafat me jetën e tyre. Në institucionin që siguron dhe edukon të mitur jetim në fatin e tyre, - u falet dhimbje, lot dhe hidhërim në vend të dashurisë, kënaqësisë dhe lumturisë feminare.

E drejta për një jetë me dinjitet dhe pa dhunë është legjitime dhe garantohet nga një seri instrumentesh kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucionet garantuese, në vend të detyrimit ligjor për shërbime mbrojtëse, ofrojnë dhunë dhe agresivitet, duke cenuar vlerat humane të qenieve të pafajshme, - fëmijët.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve duke qënë i ndjeshëm ndaj çështjeve që lidhen me garantimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, shpreh indinjatën dhe shqetësimin maksimal për ndodhjen e kësaj ngjarjeje.

Institucionet ligjvënëse në vend, duhet dhe pritët të jenë shumë të ndjeshëm ndaj dhunës dhe të reagojnë me masat e duhura ndëshkimore në kohë me efikasitet dhe efektivitet. Mbrojtja e çdo fëmije është detyrim human dhe ligjor për cilindo individ, dhe të gjithë të jemi vigjilent dhe ndëshkues përballë këtyre akteve denigruese dhe indinjuese.

Kurimi i dinjitetit të të miturve të dëmtuar tashmë do marr shumë energji dhe përkushtim, nga sa do të merrte parandalimi i këtyre mizorive njerëzore të ndodhura.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve